# DËSHMI ARKIVI

**A-472147**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nis mbledhja e firmave për referendum për bashki”/ Zhupa nga Ksamili: Kërkojmë të respektohet vullneti dhe nevojat e qytetarëve |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/nis-mbledhja-e-firmave-per-referendum-per-bashki-zhupa-nga-ksamili-kerk-i106216` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 17:01:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 17:01:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `95ff097a89a41efcacd8da0acdf87f3ac0f5935c50322fed33cec6317cddecfb` |
| TEKSTI | `6345b0c776a72aa32cb9fec499e134f4b64d5d6e64e05ec433ea5945f8e01725` |
| PAMJA | `124e6dbd22861da55db33e3bda49f3e40e56be51db84728bd827597353562a1d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `82b7c16dcea4ba96ba2bc7737ef61543175653f4086b82cfd8bc69fcc9a9babd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/82b7c16dcea4ba96ba2bc7737ef61543175653f4086b82cfd8bc69fcc9a9babd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# “Nis mbledhja e firmave për referendum për bashki”/ Zhupa nga Ksamili: Kërkojmë të respektohet vullneti dhe nevojat e qytetarëve

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 19:01



Drejtuesja politike e Partisë Demokratike për rrethin e Sarandës, deputetja Ina Zhupa, ka bërë të ditur nisjen e mbledhjes së firmave në Ksamil për organizimin e një referendumi për krijimin e bashkisë së re të Ksamilit. Në një reagim nga takimet me banorët, Zhupa tha se iniciativa vjen si përgjigje ndaj kërkesës së komunitetit për shërbime publike më pranë qytetarëve dhe një administratë vendore më funksionale.

Ajo theksoi se PD e ka përfshirë Ksamilin si bashki më vete në projektligjin e saj për reformën administrative-territoriale, ndërsa kritikoi projektin e PS-së për shkrirjen e 15 bashkive, duke kërkuar që vullneti i banorëve të merret në konsideratë.

Statusi i plotë i Ina Zhupës:

KSAMILI BASHKI!

Në Ksamil kemi nisur mbledhjen e firmave për referendum, duke iu përgjigjur kërkesës së banorëve për krijimin e bashkisë së re.Ky është një proces që nis nga nevoja e qytetarëve për të pasur shërbimet publike më pranë, një administratë më funksionale dhe një bashki që i përgjigjet drejtpërdrejt nevojave të komunitetit. Partia Demokratike ka paraqitur projektligjin e saj për reformën administrative-territoriale, ku Ksamili parashikohet si bashki më vete. Këtë qëndrim e kemi mbajtur pasi kemi bërë çdo përpjekje për një reformë të përbashkët nga komisioni i reformës dhe që funksionon në interes të qytetarëve dhe jo një hartë të re administrative të vendosur për interesa politike.

Në të kundërt, PS ka paraqitur një projekt që parashikon shkrirjen e 15 bashkive, pa iu përgjigjur kërkesës së qytetarëve për shërbime më të afërta dhe administratë vendore më funksionale dhe pa dëgjuar zërin e tyre që e kundërshtojnë fuqishëm këtë plan.

Ksamili i ka të gjitha kapacitetet për të qenë bashki. Ka një ekonomi të zhvilluar, të ardhura të konsiderueshme nga aktiviteti ekonomik dhe turizmi, potencial të jashtëzakonshëm zhvillimi, një komunitet të madh banorësh dhe një peshë të rëndësishme në ekonominë e jugut të Shqipërisë.

Një Ksamil me bashki më vete do të thotë vendimmarrje më pranë qytetarit, përgjegjësi më e drejtpërdrejtë, shërbime më të aksesueshme dhe mundësi më të mëdha për të menaxhuar vetë potencialin e jashtëzakonshëm të kësaj zone.

Vullneti i qytetarëve duhet të dëgjohet dhe të respektohet!

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 26 Shtator18:41

Aktivistja 'masakron' deputetin: Erion Braçe u kartoh, ça thotë shefi ti votoh

Aktivistja Arvina Lleshi ka 'shenjëstraur' sërish deputetin e PS, Erion Braçe, teksa tanimë socialistët janë v&eum...

POLITIKE 26 Shtator17:33

**'Disa histori i kam jetuar, ka shumë për të thënë'/ Çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri? Publikon videon 'enigmatike'**

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, ka surprizuar me postimin e tij të fundit në rrjetet sociale. Në postimin e tij, Tahiri shkruan:...

POLITIKE 26 Shtator17:17

**"As Netflix s'do ta imagjinonte. Skenar apokaliptik"/ Artan Hoxha për skandalin e Vlora Hysenit: Kjo që ndodhi me SHISH-in nuk do ta arrinte as një shërbim armik**

Gazetari Artan Hoxha ka komentuar në emisionin "Kjo Javë" në News24, me gazetaren Nisida Tufa, arrestimin e ish-drejtores së SHI...

POLITIKE 26 Shtator17:11

**Heshtja e Ramës në OKB për Kosovën/ Bardhi: Histori e turpshme që s'duhet të kalojë në heshtje!**

Për kreun e grupit parlamentar të PD, Gazment Bardhi, Edi Rama po e përdor Kosovën për propagandë ditore, pas heshtjes së k&e...

POLITIKE 26 Shtator17:02

**Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues**

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i kërkon kryetarit të Kuvendit, zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ngritjen e...

POLITIKE 26 Shtator16:54

**Nga NATO te misionet në Afganistan dhe Jeruzalem, kush është Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së në Shqipëri**

Gjenerallejtënant në pension i Forcave Speciale amerikane, Eric Wendt, merr zyrtarisht sot detyrën e ambasadorit të ri të Shteteve t&eu...

POLITIKE 26 Shtator16:13

**Ambasadori i ri në Tiranë, Ambasada Amerikane: Çojmë përpara përparësitë e administratës Trump**

Ambasada e SHBA në Tiranë ka reaguar pasi Eric Wendt mori zyrtarisht detyrën, duke dorëzuar letrat kredenciale te Bajram Begaj në Palla...

POLITIKE 26 Shtator14:30

**Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit Eric Wendt: SHBA do japë ndihmë substanciale për çmontimin e narkoshtetit**

Kryetari i PD, Sali Berisha në bashkëbisedimin me qytetarët në rrjetet sociale, ka komentuar ardhjen e ambasadorit të ri të Shte...

POLITIKE 26 Shtator13:39

**Xhixho: 400 miliardë lekë në vit në ndërtim, nga vijnë këto para?**

Erisa Xhixho ngre pikëpyetje mbi burimin e parave që financojnë sektorin e ndërtimit në Shqipëri, duke iu referuar një qark...

POLITIKE 26 Shtator13:36

**Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe...**

Sali Berisha ka zhvilluar një komunikim me qytetarët, ku ka komentuar zhvillimet e fundit politike dhe aktivitetet e Partisë Demokratike në...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 26 Shtator

**E TRISHTË/ Këta janë Flori dhe Florida, vëlla e...**

Personat që shihni në foto janë Flori dhe Florida Hoxha, motër e vëlla, të cilët humbën jetën tragjikisht pas shp...

AKTUALITET 25 Shtator

**Zbardhet lista/ 44 restorantet ku u tregtua dja...**

Pas alarmit të dhënë për hyrjen në Shqipëri të një loti të kontaminuar djathi "Brie" nga Italia, zbardhet nga media...

AKTUALITET 26 Shtator

**Operacion i befasishëm i SPAK/ Arrestohet në Sh...**

Policia e Shtetit dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, nën drejtimin e SPAK, kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Muri i Lart&e...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

**[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!]**

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**





**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.